



ERZBISTUM
HAMBURG

Mesazhi baritor nga kryeipeshkvi Dr. Stefan Heße

– me rastin e festës së Shën Ansgarit 2022



Mesazhi baritor nga kryeipeshkvi Dr. Stefan Heße

– me rastin e festës së Shën Ansgarit 2022

Të dashur motra dhe vëllezër në kryeipeshkvinë e Hamburgut,

në javët dhe muajt e fundit kam pas mundësi të zhvilloj shumë biseda me komitetet, grupet e ndryshme, si dhe me individë nga kryeipeshkvia jonë. Shpesh kemi shikuar në retrospektivë muajt e kaluar dhe më pas kemi shikuar edhe misionin tonë në të ardhmen. Jam shumë mirënjohës për këto takime dhe impulse shpesh shumë intensive. Shumica prej tyre rezonojnë vazhdimisht në mua.

Gabimet e mia në trajtimin e abuzimit seksual në kryedioqezën e Kölnit kanë bërë që shumë prej jush të ndihen të pasigurt, besimi është thyer, braktisja është shtuar. Tek disa kam hetuar gjithashtu zemërim, deri në dëshpërim ndaj Kishës. Kjo gjë më dhemb dhe më vjen shumë keq për gabimet e mia. Edhe unë jam përgjegjës për këtë situatë.

Jetojmë në një kohë krize për Kishën në Gjermani dhe në tërësi. Po përjetojmë një ngecje reformash në Kishë - gjithashtu në kryedioqezën e Hamburgut. Veç kësaj, janë edhe sfidat e shkaktuara nga Corona, që na rëndojnë të gjithëve dhe në të njëjtën kohë përshpejtojnë sërish ndryshimet.

Vendimi i Papës, për të mos pranuar dorëheqjen time dhe diskutimet e shumta gjatë javëve të fundit, më nxisin të përmbush me këmbngulësi përgjegjësinë time ipeshkvore. Para meje është një detyrë e qartë për të përmbushur si për veten time ashtu edhe për ndryshime sistematike. Realiteti i Kishës na paraqet detyra, nga të cilat unë ne nuk mund dhe nuk duhet të fshihemi! Jemi duke u përballur me përmbysje të bujshme. Skenarët e përmbysjeve mund të na frikësojnë; por ne mund t'i shohim ato edhe si thirrje dhe mundësi.

Të dashur besimtarë të krishterë, nga muajt e fundit kam mësuar shumë dhe jam gati t'î pranoj dhe t'î formësoj sfidat. Sipas meje, përparësi kanë tematikat dhe detyrat e mëposhtme:

Parandalimi, ndërhyrja dhe rivlerësimi

Parandalimi i abuzimit seksual është një komponent i rëndësishëm i veprimit profesional - siç është një përpunim i qëndrueshëm, për t'u vënë drejtësi atyre që preken nga dhuna seksuale dhe përvojat e tyre shumë të dhimbshme.

Të gjithë punonjësit e rregullt dhe vullnetarët në kryedioqezën e Hamburgut duhet të dëshmojnë se kanë ndjekur një kurs trajnimi për parandalim mbi temën e dhunës seksuale dhe në fillim të shërbimit të tyre duhet të dorëzojnë një çertifikatë të zgjeruar të lejes nga policia. Përndryshe shërbimi i rregullt në dioqezën tonë nuk është i mundur.

Të gjitha famullitë dhe institucionet në kryedioqezën e Hamburgut janë të detyruara të zhvillojnë dhe zbatojnë një koncept të mbrojtjes institucionale. Kjo duhet të dorëzohet më së voni deri më 1 tetor 2022. Deri atëherë, të gjitha hapat e zhvillimit duhet të paraqiten me një plan të detyrueshëm. Proceset e nevojshme të zhvillimit janë të njohura dhe shpesh tashmë të filluara. Shumë institucione kanë dorëzuar tashmë konceptin e tyre të mbrojtjes dhe e kanë certifikuar atë në vitin 2021. Tash e tutje zbatimi i konceptit të mbrojtjes do të jetë gjithmonë objekt i vizitës ipeshkvore.

Ndërkohë është duke u formuar një këshill për të prekurit dhe një komision i pavarur për rivlerësim së bashku me dioqezat e Osnabrück-ut dhe Hildesheim-it. Kjo do të thotë se përveç projektit rajonal që tashmë është duke u zhvilluar në Mecklenburg, do të ketë një projekt të përgjithshëm, që do të merret me abuzimin seksual për kryedioqezën tonë.

Po punojmë me vendosmëri për të kundërshtuar strukturat dhe proceset që mund të nxisin çdo formë abuzimi. Prandaj, kemi krijuar tashmë disa baza të forta për këtë në kryedioqezën tonë, si p.sh. përmes proceseve të qarta në një shumëllojshmëri të gjerë procedurash, të cilat duhen kontrolluar vazhdimisht.

Dëshiroj të theksoj shprehimisht se, do ta drejtojmë vëmendjen tonë edhe ndaj të gjitha formave të abuzimit shpirtëror dhe do të zhvillojmë kritere dhe procedura në bashkëpunim të ngushtë me Konferencën Ipeshkvore të Gjermanisë. Në kryedioqezën tonë ka një grup pune që mund të pyetet për këtë temë.

Unë do të kujdesem që informacioni për proceset në fushën e parandalimit, ndërhyrjes dhe rivlerësimit të jetë transparent dhe publik. Në të ardhmen do të ketë gjithashtu një raport vjetor gjithëpërfshirës të aktivitetit.

Jam i vetëdijshëm - pikërisht për atë që më kanë thënë të prekurit, se: Asnjë masë dhe asnjë shërbim njohjeje nuk do të mund të shërojë kurrë vuajtjet e të prekurve. Por, ne me këtë hap dhe me hapa të tillë po veprojmë fuqishëm për të siguruar mbrojtjen më të mirë të mundshme.

Kisha që shërben – pranë njerëzve

Së bashku me Jezusin duam të jemi pranë njerëzve. Jemi në rrugë së bashku me njerëzit në Veri, në baticat dhe zbaticat e jetës së tyre. Si ipeshkëv, do të fokusohem edhe më shumë se më parë dhe do të mbroj të dobëtit dhe të marginalizuarit. Prandaj kam vendosur të takoj dhe dëgjoj më shpesh njerëz në institucione të ndryshme sociale. Përqëndrohem mbi të gjitha te pyetja e Jezusit: “Çka dëshiron të bëj për ty?” (Lk 18, 41)

Unë e shoh Kishën tonë si një komunitet shërbyes. Kjo shkon paralelisht me forcimin e Caritasit. Mendoj për veprimet personale të secilit individ dhe, natyrisht, të Caritasit tonë si shoqatë, por mbi të gjitha të Caritas-it të komunitetit. Për mua, një qëndrim bamirës është thelbësor dhe largpamës. Caritasi duhet të

ftojë rëndësi në kujdesin baritor të kryedioqezës dhe famullive tona. Si hap i parë do të doja të ftoja aktorët dhe t'i lidhi ngushtë me njëri-tjetrin.

Kisha që mëson – kultura e bashkëpunimit tonë

Pushteti shpalos dinamikën e vet në të gjitha marrëdhëniet shoqërore. Sigurisht pushteti nuk duhet të përdoret kurrë për të lejuar një person të sundojë dhe të dominojë një person tjetër – para së gjithash jo në Kishë. Sidomos jo, nëse ai ose ajo mban një post ose një pozicion më të lartë në hierarki. Aty ku ndodh kjo, pushteti abuzohet.

Do të doja që „parimi i barazisë“ të zbatohet në kryedioqezën e Hamburgut: Vullnetarët dhe punëtorët e rregulltë, priftërinjtë dhe laikët, punonjësit dhe menaxherët duhet të përdorin pushtetin që kanë, për t'u takuar si të barabartë. Kjo vlen edhe për ipeshkvinjtë dhe natyrisht edhe për mua. Shenja që i paraprinë çdo dallimi legjitim mes nesh është se ne, si popull i Hyjit, ecim së bashku dhe jemi „Kishë në marrëdhënie“.

Në bisedat e muajve të fundit kam vënë re edhe lëndime nga njerëz që e kanë përjetuar me dhimbje ndryshe. Prandaj, do të doja të bëja pesë njoftime dhe sugjerime konkrete në frymën e një Kise që mëson.

Së pari: Në muajt e ardhshëm do të krijohet një sistem i menaxhimit të ankesave në kryedioqezën e Hamburgut. Konkursi për plotësimin e vendpunësimit do të shpallet në fund të këtij tremujori. Kjo bën të mundur adresimin e ankesave tek personat e pavarur të kontaktit, të cilët sigurojnë që të ruhet një kanal i besueshëm ankesash me përgjegjësi të qarta.

Së dyti: Unë dua të rris efektivitetin e punës së forumit tonë dioqezan. Si mund të punojmë më me pjesëmarrje? Si të bëhemi një Kishë më sinodale? Për ta sqaruar këtë, jemi duke vlerësuar forumet tona dhe jemi në proces të zhvillimit të mëtejshëm të Këshillit Baritor Dioqezan dhe Këshillit Ekonomik. Këshilli

Kryepeshkvor do të pushojë për një kohë të pacaktuar dhe në vend të tij do të doja të ftoja grupe rezonancë për çështje specifike.

Së treti, do të zhvillojmë më tej punën e personelit tonë dhe do të forcojmë komunikimin tonë. Përmirësimi i kulturës sonë të reagimit (Feedback-Kultur) duhet të jetë një çështje kyçe e krijimit të personelit. Unë pres të zhvillohet dhe të zbatohet një kulturë funksionale e reagimit në të dyja drejtimet. Një instrument i rëndësishëm për këtë janë vlerësimet e detyrueshme vjetore të bashkëpunëtorëve. Është duke u zbatuar një program për avancimin profesional të grave në kryedioqezën e Hamburgut. Për më tepër, sektori i personelit do të publikojë standarde të reja për procedurat e aplikimit.

Së katërti: Edhe unë vetë dua të angazhohem për një komunikim më të mirë. Unë do të ofroj një orë të rregullt për bisedë të hapur dixhitale. Informacioni për këtë do të jetë i disponueshëm së shpejti në faqen tonë të dioqezës, si për të punësuarit e rregulltë, ashtu edhe për vullnetarë. Po mendoj edhe për një “ditë të hapur të kuries ipeshkvore” për të gjithë punonjësit me kohë të plotë dhe vullnetare.

Së pesti, mbetem i përkushtuar ndaj projekteve tona të vazhdueshme për modelet e reja të drejtimit të famullisë. Duhet të ndryshojmë diçka. Kjo është arsyeja pse kam porositur një projekt tjetër personeli të titulluar “vazhdo si misionar”, i cili gjithashtu duhet të zhvillojë dhe vlerësojë formatet eksperimentale të punës në fusha të tjera baritore. Një grup projekti pjesëmarrës do të formohet në tremujorin e parë të këtij viti.

Afër Hyjit

Të dashur motra dhe vëllezër,

në përfundim të kësaj letre, më lejoni të trajtoj atë që unë e shoh si burimin e krishterimit tonë. Në Besëlidhjen e Vjetër lexojmë për kthimin e popullit të Izraelit në Jerusalem, i cili ishte një qytet i rrënuar në atë kohë. Shërbesa hyjnore

në tempull u rivendos dhe besimi u ringjall. Në fund të shpjegimit të tij, shkrimtari Ezdra thotë: “Mos u trishtoni; sepse gëzimi i Zotit është fuqia juaj.” (Neh 8, 10)

Jam plotësisht i bindur se kjo vlen edhe për ne: Aty, ku shprehet gëzimi i Zotit, ne jemi vërtet të fortë, rrezatojmë dhe kemi diçka për të dhënë.

Tani nuk është e lehtë të dhurosh një gëzim të tillë, por për pikëpamjen dhe qëndrimin tonë secili mban përgjegjësinë e vet. Do të doja të kishte më shumë hapësirë në Kishën tonë për soditje, reflektim, meditim apo thjesht për lutje të heshtur. Përveç kremtimit të Eukaristisë, është e rëndësishme të gjallërohet shumëllojshmëria e formave të adhurimit dhe të shpalljes. Si ipeshkëv, do të doja të kontribuoja për këtë dhe të lutem me ju vazhdimisht, pa qenë gjithmonë kryesuesi i kremtimit. Në të ardhmen, të mërkurën e parë të muajit, për herë të parë të Mërkurën e Përhimjes, do t'i ftoj rregullisht njerëzit në adhurimin e heshtur para të Shenjtërueshmit Sakrament në mbrëmje, nga ora 19:00 deri 21:00, në katedralen e Shën Mërisë. Për këtë, do t'i kisha lutur gratë dhe burrat që të japin impulse për tekstet e leximit për të dielën e ardhshme. Përndryshe, do të qëndrojmë me Zotin në heshtje dhe do të përfundojmë me lutjen e Pasmbrëmësore. Në një atmosferë ndonjëherë ngulfatëse, lutja është si një frymëmarrje e fuqishme, pa të cilën na mungon ajri.

Me këtë fjalë nuk përfundon gjithçka. Përkundrazi: evoluimi i kryedioqezës së Hamburgut vazhdon dhe duhet të përshejtohet. Unë jam gati për këtë sfidë dhe ju ftoj të gjithëve të vazhdojmë të punojmë së bashku.

Me bekimet më të mira mbetem

kryeipeshkëvi Juaji



Erzbischof Dr. Stefan Heße



ERZBISTUM
HAMBURG

Erzbistum Hamburg
Am Mariendom 4
20099 Hamburg
www.erzbistum-hamburg.de